



Pranuar / Dorezuar Pritmjenoh/Prodato Received/Delivery	27 - 03 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	3020/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.392/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.392/2023 të datës 22.02.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____

_____ kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.392/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ është i punësuar në Komunën e Lipjanit, sipas Akt emërimit të datës 01.04.2011 në pozitën "Inspektor i Trafikut" në Drejtorin për Inspektorat.

Me datën 10.02.2023 përmes shkresës me numër 1-120/04-7639, i është drejtuar me kërkesë Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Lipjanit, lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive për pjesën e humbur të pagës në vlerën e dy (2) koeficienteve që nga viti 20.11.2014 e deri me datë 31.01.2023. Ndërsa Njësia e Personelit të kësaj Komune me datën 10.02.2023 përmes përgjigjes në kërkesë, i është përgjigjur ankuesit se kanë pranuar vendimin me datën 23.01.2023 me SKPMSHCK me numër 680/2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për përfundim procedimi administrativ të ankesës tuaj për harmonizim të koeficientit dhe kompensim dhe se zyra e personelit nuk është kompetente për ndryshim të koeficientit, ndryshimi i koeficientit mund të bëhet vetëm me zhvillimin e procedurave të rekrutimit siç parashihet me ligj.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Udhëheqëses së Personelit të Komunës së Lipjanit të datës 10.02.2023, me datën 22.02.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1971/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që ti bëhet pagesa e diferencës për fitimin e humbur nga gjashtë (6) në tetë (8) në vlerën e dy koeficienteve në harmoni me shkresën e DASHC/MAP 04/1571 të datës 20.11.2014, konkretisht ti bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive prej datës 20.11.2014 e deri 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa Këshilli më datë 08.03.2023 përmes e-mailit zyrtar ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Lipjanit me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1971/2023 të datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin e të datës 01.04.2011; Kërkesë për kompensimin në mënyrë retroaktive për pjesën e humbur të pagës e ankuesit me numër 1-120/04-7639 të datës 10.02.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 10.02.2023; Shkresa e DASHC/MAP e datës 20.11.2014; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2186/2023 e datës 28.02.2023; Përgjigje në ankesë e datës 08.03.2023; Përgjigje në ankesë me numër reference 2/86/2023 e datës 07.03.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 09.10.2012; Kërkesë për pagë shtesë për vëllimin e punës me numër reference 01-400/01-7249 i datës 08.02.2023; Vendim i datës 26.01.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.392/2023 i datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet pagesa e diferencës për fitimin e humbur nga gjashtë (6) në tetë (8) në vlerën e dy koeficienteve në harmoni me shkresën e DASHC/MAP 04/1571 të datës 20.11.2014, konkretisht ti bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive prej datës 20.11.2014 e deri 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesit, ka konstatuar se ankuesi për objektin e njëjtë dhe me pretendimet e njëjta më datë 08.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7763/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.1115/2022 të datës 23.01.2023 ka shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të njëjtën ka vendos përfundim procedimi administrativ.

Bazuar në këtë Kolegji, konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për ankesën e ankuesit për objektin e njëjtë dhe pretendimet e njëjta sipas Vendimit A.nr.1115/2022 të datës 23.01.2023, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesit në përputhje me nenin 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike*". Andaj Kolegji që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.392/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ në përputhje me dispozitat e lartshënuara.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.392/2023

Clirim ZEKA


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

